

QENDRA KULTURORE E KOMUNËS SË MEDVEGJËS
16240 Medvegjë, Gjyre Jakshiq 6,
Tel: 016 / 891-961

Në bazë të nenit 35. dhe 36. të Ligjit mbi Kulturën (“Gazeta Zyrtare e RS” nr. 72/2009, 13/2016, 30/2016 korrigjuar, 6/2022, 47/2021 dhe 78/2021), nenet 36, 39 dhe 40 të Statutit të Qendrës Kulturore të Komunës së Medvegjës dhe Vendimit të Këshillit Drejtues të Qendrës Kulturore të Komunës së Medvegjës numër 143-4/2022 datë 15.04.2022. vit, Këshilliu i Drejtues të Qendrës Kulturore të Komunës së Medvegjës shpall;

KONKURSIN PUBLIK PËR ZGJEDHJEN E DREJTORIT

KUSHTET: Për zgjedhjen e drejtorit të Qendrës Kulturore të Komunës së Medvegjës mund të aplikojnë kandidatët të cilët përveç kushteve të përgjithshme të parapara me ligj i dhe kanë këto kushte:

- Arsimi i lartë (arsimimi i lartë i përshtatshëm në studimet e shkallës së dytë-studime të diplomuara akademike-master; studime profesionale apo studime të specializuara akademike apo arsim i lartë në studime universitare që zgjasin të paktën katër vite)
- të paktën pesë vjet përvojë pune në kulturë.
- provimin profesional shtetëror
- njohja e një gjuhe botërore
- njohja e punës në kompjuter

Dokumentacioni i konkurrencës për përzgjedhjen e kandidatëve, së bashku me aplikimin, duhet të përmbajë dëshmitë e mëposhtme:

- propozimin e programit të punës dhe zhvillimit të Qendrës Kulturore të Komunës së Medvegjës për periudhë 4 vjeçare,
- diplomë apo certifikatë mbi kualifikimin e fituar profesional
- librezë e punës, gjegjësisht dëshmi tjetër e përvojës së punës nga e cila mund të përcaktohet se në cilat vende pune dhe me cilën kualifikim profesional është fituar përvoja e punës;
- biografia e kandidatit (SV);
- vërtetim, jo më i vjetër se gjashtë muaj, se kandidati nuk është duke u hetuar dhe se ndaj tij nuk është ngritur asnjë kallëzim për vepra penale për të cilat ndiqet sipas detyrës zyrtare;
- vërtetim se kandidati nuk është dënuar;
- vërtetim mbi shtetësi së Republikës së Serbisë (jo më e vjetër se gjashtë muaj);
- certifikate nga libri i të lindurve;
- certifikatën e provimit profesional shtetëror
- fotokopje e letërnjoftimit
- dëshmi për njohjen e një gjuhe të huaj
- certifikatë mjekësore mbi shëndetin e përgjithshëm

Dëshmit në fjalë bashkëngjiten në origjinal apo kopje të vërtetuar nga institucioni kompetent.

Drejtori emërohet në periudhë katërvjeçare.

Konkursi publik do të publikohet në faqen e internetit të Këshillit Nacional për punësim dhe në gazetën ditore „Danas“, si dhe në faqen e Qendrës Kulturore të Komunës së Medvegjës.

Afati për dorëzimin e aplikacioneve është 15 ditë nga dita e shpalljes së konkursit publik.

Aplikimet e pakompletuara dhe të parakohshme nuk do të shqyrtohen.

Dokumentacioni i nevojshëm i konkursit duhet të dorëzohet personalisht ose në adresën: Qendra Kulturore e Komunës së Medvegjës, Gjyre Jakshiq 6, 16240 Medvegjë, me shënimin: “Konkursi për Drejtor”.

Numër: **180/2022**

Data: **18.05.2022.** viti

kryetar i Këshillit Administrativ

Ivana Miqoviq

